

## AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
**“STIR DURAZZO COMPANY” SH. P. K.**

Sot, më datën 28/12/2020, Z. Blerdi Hajdinolli lindur në Manëz, Shqipëri, me datë 18 Janar 1979, banues në Sukth, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe Z. Hate Hajdinolli, i lindur në Hondisht-Pogradec, me datë 05 Prill 1965, banues në Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“STIR DURAZZO COMPANY” Sh. P. K.** si më poshtë vijon

### Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin **“STIR DURAZZO COMPANY”**

Ortakë të kësaj shoqërie janë Z. Blerdi Hajdinolli–dhe Z. Hate Hajdinolli.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. Blerdi Hajdinolli per një periudhe deri ne 5 vjet.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

### Neni 2

Shoqëria **“STIR DURAZZO COMPANY”** gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Sh. P. K.”**. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë **“STIR DURAZZO COMPANY”** SH.P.K. është DURRES, **“Lagjja nr. 4, Rruga “Fetah Blaca”, Pallati nr.1133, zona Kadastrale 8514,Kati i trete.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themeli dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

### Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

### Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitet me objekt:

- Import, eksport, hekurosje, transport etj.

- Ushtrimit te çdo veprimtarie te ligjshme, te lejueshme per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj [sipas nenit 7 te ligjit tregtar nr.9901,dt.14.04.08].
- Qepje konfeksione me material porositesi.

#### **Neni 5**

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne një numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron një kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshtë:

**Z. Blerdi Hajdinolli** zotëruesh i një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

**Z. Hate Hajdinolli** zotëruesh i një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakeve mund te jetë ne para ose ne natyre ( pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta ). Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialat e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

### **ORTAKET E SHOQERISE**

**BLERDI HAJDINOLLI**

**HATE HAJDINOLLI**